



Njoftimet për shtyp

**Njoftime të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës** —

Njoftime mbi vendimmarrjen e politikës monetare

**Njoftime të tjera të KM**

Konferenca për shtyp

Fjalime, intervista, artikuj +

Kalendarë +

Kalendari i festave zyrtare për vitin 2026

COVID-19

Evropa

## BANKA E SHQIPËRISË

# NJOFTIM PËR SHTYP

Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 1 prill 2026

**Data e publikimit: 01.04.2026**

Në mbledhjen e datës 1 prill 2026, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe vendosi:

- **Emërimin e Zëvendësgubernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit 8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Gubernatorit, Këshilli Mbikëqyrës zgjodhi dhe emëroi zj. Holta Zaçaj në funksionin e Zëvendësgubernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë.

- **Miratimin e Deklaratës dhe Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë 2025**

Raporti i Stabilitetit Financiar është një nga dokumentet e rëndësishme periodike të përgatitura nga Banka e Shqipërisë, me qëllim kryesor identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve me të cilat operon sistemi financiar dhe infrastruktura e tij. Në hyrje të dokumentit vendoset Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi çdo gjashtë muaj i së cilës është një kërkesë që buron nga Ligji "Për Bankën e Shqipërisë".



Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, veprimtaria e sistemit financiar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme. Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar u përshpejtua, me kontribut kryesor nga rritjet e depozitave dhe të kapitalit, të cilat u orientuan kryesisht drejt kreditimit dhe investimeve në tituj. Rezultati financiar neto i sektorit bankar ishte pozitiv dhe disi më i ulët se ai i një viti më parë. Rreziqet që burojnë nga ndërlidhjet mes sektorit bankar dhe segmenteve të tjera të sistemit financiar, si edhe ato të veprimtarisë së vetë sektorit bankar, vlerësohen në nivele të kontrolluara. Treguesit e rezistencës financiare dhe ushtrimet e provës së rezistencës, tregojnë se sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj rreziqeve të identifikuar. Megjithatë, mbetet e nevojshme që bankat të forcojnë sistemet e tyre të parandalimit dhe të administrimit të rreziqeve, të testojnë rregullisht rezistencën ndaj tyre, si dhe të ruajnë nivelet e përshtatshme të kapitalizimit të veprimtarisë.

Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës ishin pozitive, ndikuar nga ecuria e mirë e konsumit dhe investimeve, dhe performanca e qëndrueshme pozitive e sektorit të turizmit. Rritja ekonomike u shoqërua me ulje të papunësisë dhe rritje të punësimit e të pagave. Politika fiskale mbeti e kujdesshme dhe pesha e borxhit publik në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), vijoi të bjerë. Presionet inflacioniste kanë mbetur nën objektivin e Bankës së Shqipërisë. Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme dhe lidhen kryesisht me pasigurinë e lartë që paraqesin aktualisht zhvillimet ndërkombëtare. Në këto kushte, mbetet e rëndësishme që politikat ekonomike dhe financiare të autoriteteve publike dhe veprimet e pjesëmarrësve të tregjeve të synojnë ruajtjen e rezervave financiare dhe drejtimin me efektivitet të investimeve të tyre.



- **Miratimin e disa ndryshimeve të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë lidhur me licencimin e bankave, subjekteve financiare jobanka, institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, shoqërive të kursim-kreditit, si edhe me kuadrin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

Ndryshimet e miratuara synojnë përmirësimin dhe forcimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës, në përputhje me standardet ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive, duke synuar kryesisht zbatueshmërinë e rekomandimeve të ekspertëve të Moneyval.

Konkretisht, këto ndryshime adresojnë përfshirjen dhe qartësimin e koncepteve “reputacion i mirë” dhe “pronar përfitues”, forcimin e kërkesave mbi integritetin dhe reputacionin e zotëruesve të kapitalit, përfshirë pronarët përfitues, si dhe përfshirjen e detyrimit për konsultimin e listave të OKB-së dhe Bashkimit Evropian në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, ato synojnë qartësimin e kërkesave rregulative lidhur me afatet dhe të drejtën e riparaqitjes së kërkesave për licencim, përmirësimin e kërkesave për dokumentacionin e nevojshëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së strukturave të pronësisë dhe drejtimit, si dhe rregullimin e aspekteve që lidhen me ndryshimet në strukturën e kapitalit të subjekteve financiare jobanka, përfshirë blerjen, shitjen apo transferimin e pjesëmarrjes influencuese, si dhe pezullimin apo revokimin e licencës.

Këto ndryshime prekin konkretisht rregulloret e mëposhtme:

- “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;
- “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive nga subjektet financiare jobanka”;
- “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”;
- “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”;
- “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.



- **Rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor 20 Lekë dhe kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor 5000 Lekë**

Këto vendime parashikojnë rishtypjen e monedhës metalike 20 Lekë dhe kartëmonedhës 5000 Lekë, me kurs ligjor, me qëllim plotësimin e kërkesave të ekonomisë për para, në vlerë dhe strukturë, si dhe sigurimin e një furnizimi të rregullt me to, për një periudhë disavjeçare.

Në përfundim, Këshilli Mbikëqyrës u njoh dhe me informacione të tjera mbi aktivitetin e përditshëm funksional dhe operacional të Bankës së Shqipërisë.